

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË - Departamenti i përgjithshëm,** përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me proqesmbajtsen Fjolla Huruglica, në lëndën penale kundër të akuzuarës M. M. nga fshati P., Komuna e N., për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 321, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II. nr. 790/ 2016, të datës 28.04.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurori i Shtetit, Ismet Ukshini, pas mbajtes së seancës së shqyrtimit fillestar gjyqësor dhe publik, më 16.01.2017, ndërsa me 17.01.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **M. M.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati R. , dhe e ëma T., e lindur N, i lindur më .... në FSH. C., Komuna e P., R. Sërbis, me vendbanim në fsh. P., tek restoranti, "F. P.", shqiptare, shtetase e R. Kosovës, e pa shkolluar, e vej, pa fëmij, e gjendjes së varfur ekonomike, jetaon nga asistenca sociale, e pa gjykuar dhe nuk din se a udhëhiqet procedur tjetër penale ndaj saj.

**Ë s h t ë f a j t o r ë**

Sepse:

Prej dates së pavërtetuar e gjerme me dt . 10.11.2015 , në shtëpinë e saj në fsh. Pasjak, si shfrytzuese e energjis elektrike , me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur energjin elektrike, me qëllim që gjatë një kontrole nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë konstatuar se e akuzuara ka bër degëzim para njehesorit elektrik me të cilin degëzim është furnizuar me energji eletrike , dhe në këtë mënyrë e akuzuara me veprimet e veta të dëmtuarës KEDS-it, Distriktit në Gjilan, I ka shkaktuar dëmë material në shumë prej 434,60 euro.

Me çka ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve komunale , nga neni 321 të KPRK-se,

andaj gjykata në bazë të nenit 4,41,51,64,73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së,

**E G J Y K O N**

*Me dënim burgu në kohë zgjatje prej 90 (nëntë dhjetë ) ditëve dhe me dënim me gjobë në shumë prej 50. (pesdhjet) €, të cilët dënim nuk kanë për tu ekzekutuar në qoftes e akuzuara në afat prej 1( një) viti nuk kryen ndonji veprë tjetër penale, në të kundërtën ky vendim do të revokohet.*

*I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili shumën prej nga 15€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së aktgjykimit, nën kërcnim të përmbarrimit të dhunshëm.*

*E dëmtuara ,K., për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.*

## **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore, në Gjiilan, me aktakuzën e ushtruar me shkrim, PP.II.nr.790/2016 , të datës 28.04.2016, e ka akuzuar M. M., nga Fsh.P..K.Novobërdë, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale , nga neni 321 të KPRK-se,*

*Prokurori i shtetit Ismet Ukshini, në seancën fillestar ka deklaryar: në tërsi mbetem pranë aktazës së ushtruar me shkrim dhe propozoj që e akuzuara të shpallet fajtorë për veprën e kryer dhe të njejtës ti shqiptohet denimi meritor sipas ligjit gjithnjë duke I marrur për bazë të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese.*

*E akuzuara M. M. në seancën fillestare ka deklaryuar: aktakuzë e lezuar nga ana e prokurorit të shtetit e kam kuptuar në tërsi, e ndiej vehten fajtorë dhe e pranoj fajësinë për veprën me të cilën ngarkohem, pendohem për të njejtën , dhe i premtoj gjykatës se nuk do të kryej vepra të kësaj natyre, dhe kërkoj nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptoj një dënim sa më i butë .*

*Gjyqtari ka vlerësuar se e akuzuara e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njejtë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit nga e të akuzuarës është bërë vullnetarisht , pa kurrfarë presioni dhe ky pranim është i mbështetur edhe në faktet e provat dhe faktet që përmban aktakuza.. Aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur, se e akuzuara M. M., në vendin dhe kohën dhe mënyrën e*

*përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve komunale , nga neni 321 të KPRK-se. Andaj të e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht dhe gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit.*

*Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehuren, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së. Kështu gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veçanarisht lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit të kushtëzuar, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjykata pati parasysh faktin se e njejta e ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, se e njejta është e shtyer në moshë, e vej, pa fëmij jeton nga asistenca sociale, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të ndermerr veprime të këtilla. Ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarën gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe pasojen e shkaktuar nga kjo vepër penale.*

*Andaj gjykata gjeti se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarës, se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarën do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave të tilla penale.*

*Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 parag.1 nën parag. 2 .6 të KPRK-së.*

*Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË.**

**- Departamenti i pergjithshëm.**

**P.nr. 29 / 2016, më 17.12.2016 .**

Gjyqtari:

*Hasan Sadiku*

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.